

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

2025

RAPORT

I statistikave të Prokurimit Publik në Kosovë!

Janar - Shtator 2025

RAPORTI I STATISTIKAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK (KRPP)

Periudha raportuese

Janar-Shtator 2025

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave.....	3
Lista e Figurave	4
Lista e Shkurtesave.....	4
HYRJE	5
Të dhëna kyçe.....	6
Të dhëna statistikore për periudhën raportuese.....	7
Aktivitetet e Anuluara të Prokurimit Publik	18
Konkluzione	25

Lista e Tabelave

Table 1 Statistika përmbledhëse të prokurimit sipas numrit të kontratave të nënshkruara	7
Table 2 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të prokurimit.....	8
Table 3 Kontratat e nënshkruara sipas vlerës.....	9
Table 4 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të procedurës	10
Table 5 Kontratat e nënshkruara sipas llojit.....	12
Table 6 Kontratat e nënshkruara sipas kategorisë së AK.....	13
Table 7 Kriteret e dhënies së kontratave.....	14
Table 8 AK sipas numrit të kontratave të nënshkruara.....	15
Table 9 AK sipas vlerës së kontratave të nënshkruara	16
Table 10 OE me vlerën më të madhe të kontratave të nënshkruara	17
Table 11 OE me numrin më të madh të kontratave të nënshkruara	17
Table 12 Arsyet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit	23
Table 13 Arsyet shtesë të anulimit të aktiviteteve të prokurimit.....	24

Lista e Figurave

Figure 1 Kontratat e nënshkruara gjatë 2025 sipas llojit të prokurimit	8
Figure 2 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit	8
Figure 3 Kontratat e nënshkruara sipas vlerës.....	9
Figure 4 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas vlerës	10
Figure 5 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të procedurës	11
Figure 6 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurës.....	11
Figure 7 Kontratat e nënshkruara sipas llojit.....	12
Figure 8 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të AK	13
Figure 9 Kontratat e nënshkruara sipas kriterit të dhënies	14
Figure 10 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas kriterit të dhënies.....	15
Figure 11 Struktura në përqindje e aktiviteteve të anuluar të prokurimit publik.....	18
Figure 12 Numri i aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës.....	19
Figure 13 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës	20
Figure 14 Numri i aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës	20
Figure 15 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës	21
Figure 16 Aktivitetet e anuluar para apo pas hapjes së ofertave	21
Figure 17 Struktura e aktiviteteve të anuluar para apo pas hapjes së ofertave	22
Figure 18 Struktura e arsyeve të anulimit të aktiviteteve të prokurimit	23
Figure 19 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas arsyeve shitesë	24

Lista e Shkurtesave

AK – Autoritetet Kontraktuese;

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;

OE – Operator Ekonomik;

TEMF- Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm;

HYRJE

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), përkatësisht Divizioni për Analizë dhe Statistikë, ka përgatitur këtë raport për periudhën janar–shtator 2025 me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi aktivitetet e realizuara në fushën e prokurimit publik nga Autoritetet Kontraktuese të Republikës së Kosovës gjatë kësaj periudhe.

Raporti përfshin të dhëna statistikore të mbledhura nga sistemi elektronik i prokurimit¹, të cilat shërbejnë si bazë për analizimin dhe paraqitjen grafike të rezultateve të prokurimit.

Gjatë periudhës raportuese janë nënshkruar gjithsej **5,762** kontrata, me një vlerë totale prej **752,706,601.74** euro. Shpërndarja e kontratave sipas kategorive kryesore është si vijon:

- **Punë:** 486,881,193.60 € (64.68%)
- **Furnizim:** 180,119,619.70 € (23.93%)
- **Shërbime:** 85,705,788.48 € (11.39%)

Nga këto të dhëna vërehet se pjesa më e madhe e kontratave të nënshkruara gjatë periudhës referuese të vitit 2025 i takojnë kategorisë së punëve (**64.68%**), të pasuara nga furnizimet (**23.93%**) dhe shërbimet (**11.39%**).

Përmes hartimit të raporteve periodike, KRPP synon të rrisë transparencën në lidhje me të dhënat e prokurimit publik dhe mënyrën e shpërndarjes së fondeve publike nga Autoritetet Kontraktuese, duke kontribuar në forcimin e integritetit dhe efikasitetit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

¹ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>

Të dhëna kyçe

Disa nga të dhënat kyçe të këtij raporti për periudhën Janar-Shtator 2025 rezultojnë si më poshtë:

1. **Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara** gjatë periudhës Janar-Shtator 2025 arrin **752,706,601.74 euro**. Nga kjo shumë:
 - **64.68%** janë kontrata për **punë** (486,881,193.60 euro);
 - **23.93%** për **furnizim** (180,119,619.70 euro);
 - **11.39%** për **shërbime** (85,705,788.48 euro);
2. **Shpërndarja sipas vlerës së kontratave:**
 - Kontrata me **vlerë të madhe**: 620,405,815.76 euro (82.42%);
 - Kontrata me **vlerë të mesme**: 122,289,131.13 euro (16.25%);
 - Kontrata me **vlerë të vogël**: 5,116,072.96 euro (0.68%);
 - Kontrata me **vlerë minimale**: 1,060,304 euro (0.14%);
 - **Minitender**: 3,835,277.89 euro (0.51%);
3. **Sipas procedurës së prokurimit:**
 - **94.21%** e kontratave (709,106,624.68 euro) janë nënshkruar përmes **procedurës së hapur** (përfshirë kuotimin e çmimeve);
 - **0.14%** me procedurë të vlerës minimale (1,060,304 euro);
 - **0.51%** minitender (3,835,277.89 euro);
 - **5.14%** e kontratave (38,704,395.17 euro) janë nënshkruar përmes **procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë**, nga të cilat:
 - **Kontrata të negociuara**: 25,928,274.05 euro (**3.44%**);
 - **Punë shtesë**: 12,776,121.12 euro (**1.70%**);
4. **Sipas kriterit të dhënies:**
 - **87.60%** e kontratave (659,359,997 euro) janë nënshkruar sipas kriterit çmimi më i ulët, ndërsa
 - **12.40%** e kontratave (93,346,604.74 euro) janë nënshkruar sipas kriterit TEMF;
5. **Autoritetet Kontraktuese sipas vlerës së kontratave të nënshkruara:**
 - Ministria e Kulturës: **63,5 milion euro**;

- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK): **51.9 milion euro;**
- Ministria e Infrastrukturës: **46.9 milion euro;**

6. Autoritetet Kontraktuese sipas numrit të kontratave të nënshkruara:

- KEK: **269 kontrata;**
- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK): **223 kontrata;**
- Qendra Klinike Universitare e Kosovës: **196 kontrata;**

Të dhëna statistikore për periudhën raportuese

Më poshtë janë paraqitur të dhënat statistikore përmblledhëse sa i përket kontratave të nënshkruara sipas llojit të kontratës, llojit të procedurës, vlerës dhe autoriteteve kontraktuese, të ndara sipas numrit të kontratave të nënshkruara. Gjatë periudhës janar – shtator 2025, janë nënshkruar gjithsej **5,762** kontrata në vlerë totale prej **752,74 milion euro**.

Table 1 Statistika përmblledhëse të prokurimit sipas numrit të kontratave të nënshkruara

	Numri	Proporcioni
Të gjitha kontratat e nënshkruara	5762	1.000
Lloji i Kontratës		
Furnizim	2862	0.496
Punë	1062	0.185
Shërbime	1838	0.319
Lloji i Procedurës		
Procedurë e hapur (përfshirë kuotimin e çmimeve)	5478	0.951
E Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	284	0.049
Sipas vlerës		
Vlerë e madhe	1038	0.180
Vlerë e mesme	2177	0.378
Vlerë e vogël	1112	0.193
Vlerë minimale	1268	0.220
Mini tender	167	0.029
Autoritetet		
Niveli Lokal	1939	0.337
Niveli Qendror	2430	0.422
Ndërmarrjet Publike	1393	0.241
Gjithsej	5762	

Table 2 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të prokurimit

LLOJI PROKURIMIT	FURNIZIM	SHËRBIME	PUNË
VLERA	180,119,619.70	85,705,788.48	486,881,193.60
TOTALI	752,706,601.74		

Gjatë periudhës janar-shtator 2025, janë nënshkruar kontrata në vlerë totale prej **752,706,601.74 euro**. Nga kjo shumë, **180,119,619.70 euro** i takojnë kontratave për furnizim, **85,705,788.48 euro** kontratave për shërbime, ndërsa **486,881,193.60 euro** për kontrata të kategorisë së punëve.




Figure 1 Kontratat e nënshkruara gjatë 2025 sipas llojit të prokurimit

Referuar strukturës në përqindje, nga vlera totale e kontratave të nënshkruara **(64.68%)** i takojnë kontratave për punë, **(23.93%)** kontratave për furnizim, ndërsa **(11.39%)** i përkasin kontratave për shërbime.




Figure 2 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit

Table 3 Kontratat e nënshkruara sipas vlerës

Vlera e kontratës	Vlerë e madhe	Vlerë e mesme	Vlerë e vogël	Vlerë minimale	Minitender
VLERA	620,405,815.76	122,289,131.13	5,116,072.96	1,060,304	3,835,277.89
TOTALI	752,706,601.74				

Gjatë periudhës raportuese, sipas vlerës së kontratave të nënshkruara, **620,405,815.76 euro** i takojnë kontratave me vlerë të madhe, **122,289,131.13 euro** kontratave me vlerë të mesme, **5,116,072.96 euro** kontratave me vlerë të vogël, **1,060,304 euro** kontratave me vlerë minimale, ndërsa **3,835,277.89 euro** janë realizuar përmes minitenderëve.




Figure 3 Kontratat e nënshkruara sipas vlerës

Sipas strukturës në përqindje, **(82.42%)** e kontratave të nënshkruara i përket kategorisë me vlerë të madhe, **(16.25%)** e kontratave janë nënshkruar me vlerë të mesme, **(0.68%)** me vlerë të vogël, **(0.14%)** janë kontrata të nënshkruara me vlerë minimale dhe **(0.51%)** janë realizuar përmes minitenderëve.




Figure 4 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas vlerës

Në tabelën më poshtë paraqiten kontratat e nënshkruara në vlerë dhe struktura e shprehur në përqindje sipas llojit të procedurës.

Table 4 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të procedurës

Lloji i procedurës	E hapur	%	Vlerë minimale	%	Minitender	%	E Negociuar	%
Vlera	709,106,624.68	94.21	1,060,304	0.14	3,835,277.89	0.51	38,704,395.17	5.14
Totali	752,706,601.74							

Gjatë periudhës raportuese, vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit është si vijon: procedura e hapur, përfshirë kuotimet e çmimit, ka arritur shumën prej **709,106,624.68 euro**, kontratat e realizuara përmes procedurës së vlerës minimale kapin vlerën prej **1,060,304 euro**, ndërsa sipas procedurës me minitender janë në vlerë prej **3,835,277.89 euro**.

Për më tepër, kontratat e nënshkruara përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë arrijnë vlerën totale prej **38,704,395.17 euro**, nga të cilat **25,928,274.05 euro** i takojnë kontratave të negociuara dhe **12,776,121.12 euro** janë të kategorizuara si punë shtesë.




Figure 5 Kontratat e nënshkruara sipas llojit të procedurës

Në grafën më poshtë është paraqitur struktura e shprehur në përqindje e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurës, nga të cilat rezulton që **(94.21%)** e kontratave të nënshkruara janë zhvilluar me procedurë të hapur, **(0.14%)** janë zhvilluar sipas procedurës së vlerës minimale, **(0.51%)** sipas minitenderit kurse me procedurë të negociuar **(3.44%)** dhe punë shtesë janë **(1.70%)**, pra në total procedura e negociuar arrinë **(5.14%)** për 9 mujorin e vitit 2025.




Figure 6 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurës

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të kontratave të nënshkruara, të klasifikuara sipas llojit, numrit dhe vlerës totale për secilin lloj kontrate.

Kontratë kornizë: Janë nënshkruar gjithsej 1,449 kontrata, me një vlerë totale prej rreth 199.65 milion euro.

Kontrata nga marrëveshjet kornizë: Për këtë lloj, janë nënshkruar 167 kontrata me një vlerë totale prej rreth 3.83 milion euro, që përfaqësojnë kontrata më të vogla, të dedikuara për shërbime ose produkte specifike dhe që burojnë nga marrëveshjet kornizë me shumë OE.

Kontratë publike: Janë nënshkruar gjithsej 4,146 kontrata, me një vlerë totale prej rreth 549.21 milion euro, duke treguar një aktivitet të madh në sektorin publik për blerje, shërbime apo punë. Numri total i kontratave të nënshkruara është **5,762** me një vlerë totale prej rreth **752.70** milion euro.

Table 5 Kontratat e nënshkruara sipas llojit

NR	LLOJI I KONTRATËS	NUMRI	VLERA	PËRQINDJA
1	Kontratë kornizë	1,449	199,654,513.67	26.52 %
2	Kontratë ndihmëse	167	3,835,277.89	0.51 %
3	Kontratë publike	4,146	549,216,810.20	72.97 %
		5,762	752,706,601.74	100 %

Grafi më poshtë paraqet shpërndarjen në përqindje të kontratave të nënshkruara sipas llojit, ku **(72.97%)** janë kontrata publike, **(26.52%)** janë kontrata kornizë dhe **(0.51%)** janë kontrata ndihmëse.




Figure 7 Kontratat e nënshkruara sipas llojit

Tabela më poshtë paraqet numrin dhe vlerën e kontratave të nënshkruara nga Niveli Qendror, Ndërmarrjet Publike dhe nga Niveli Lokal. Gjatë periudhës raportuese, nga Niveli Qendror janë nënshkruar 2,430 kontrata në vlerë prej 370,791,862.81 euro. Ndërmarrjet Publike kanë nënshkruar 1,393 kontrata në vlerë prej 62,918,884.02 euro, kurse Niveli Lokal gjithsej ka nënshkruar 1,939 kontrata në vlerë totale prej 318,995,854.91 euro.

Table 6 Kontratat e nënshkruara sipas kategorisë së AK

	Niveli Qendror		Ndërmarrjet Publike		Niveli Lokal	
	Numri i kontratave	Vlera	Numri i kontratave	Vlera	Numri i kontratave	Vlera
Total	2430	370,791,862.81	1393	62,918,884.02	1939	318,995,854.91

Sipas strukturës së shprehur në përqindje **(49.26%)** e kontratave të nënshkruara janë nga Niveli Qendror, **(8.36%)** nga Ndërmarrjet Publike dhe **(42.38%)** e kontratave të nënshkruara janë nga Niveli Lokal.




Figure 8 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas llojit të AK

Tabela më poshtë paraqet vlerën e kontratave të nënshkruara nga Autoritetet Kontraktuese, bazuar në kriterin e dhënies. Sipas kriterit të dhënies tenderi i përgjegjshëm me çmimin më ulët, janë nënshkruar kontrata në vlerë prej 659,359,997.00 euro. Ndërsa, sipas kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm, janë nënshkruar kontrata në vlerë prej 93,346,604.74 euro.

Table 7 Kriteret e dhënies së kontratave

Kriteret për dhënie të kontratës	Numri i Kontratave	Vlera e Kontratave	Struktura në Përqindje
Çmimi më i ulët	5,594	659,359,997	87.60%
Tenderi ekonomikisht më i favorshëm	168	93,346,604.74	12.40%
GJITHSEJ	5,762	752,706,601.74	100%

Pjesa më e madhe e kontratave të nënshkruara janë shpërblyer sipas kriterit të dhënies çmimi më i ulët, apo shprehur në përqindje **(87.60%)**, kurse sipas kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm janë dhënë **(12.40%)** e kontratave.




Figure 9 Kontratat e nënshkruara sipas kriterit të dhënies

Struktura e kontratave të nënshkruara sipas kriterit të dhënies




Figure 10 Struktura e kontratave të nënshkruara sipas kriterit të dhënies

Tabela më poshtë paraqet 20 Autoritetet Kontraktuese sipas numrit të kontratave të nënshkruara gjatë periudhës raportuese. Nga këto AK, rezulton që KEK ka nënshkruar më së shumti kontrata në total gjithsej 269, SHSKUK 223 kontrata, QKUK 196 kontrata e duke u pasuar nga të tjerat sipas renditjes në listën më poshtë.

Table 8 AK sipas numrit të kontratave të nënshkruara

Nr	Autoriteti Kontraktues	Numri i kontratave
1	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.	269
2	SHSKUK - Shërbimi Spitalor i Klinikës Universitare të Kosovës	223
3	Qendra Klinike Universitare Kosovës	196
4	Kuvendi Komunal i Prizrenit	129
5	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	125
6	Agjencia Qendrore e Prokruimit	112
7	Ministria e Shëndetësisë	106
8	Komuna e Gjakovës	102
9	Komuna e Vushtrrisë	101
10	Komuna Ferizaj	100
11	Kuvendi Komunal Lipjan	97
12	Komuna Suharekë	93
13	Oper. Sistemi,Trans. dhe Tregu - KOSTT Sh.A.	89
14	Komuna e Podujevës	88
15	Komuna Shtime	87
16	Kuvendi Komunal i Klinës	80
17	Policia e Kosovës	80
18	Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP	78
19	Komuna e Kamenicës	76
20	Kuvendi Komunal Mitrovicë	76

Tabela më poshtë paraqet 20 Autoritetet Kontraktuese të radhitura sipas vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë periudhës Janar-Shtator 2025. Nga këto AK, rezulton që Ministria e Kulturës ka nënshkruar më së shumti kontrata vlerë prej **63.56** milion euro, SHSKUK ka nënshkruar kontrata në vlerë prej **51.96** milion euro, Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej **25.6** milion euro dhe AK të tjera sipas renditjes sipas listës më poshtë.

Table 9 AK sipas vlerës së kontratave të nënshkruara

Nr	Autoriteti Kontraktues	Vlera e kontratave
1	Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK	63,565,007.74
2	Shskuk - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës	51,960,637.36
3	Ministria e Infrastrukturës	46,927,291.13
4	Kuvendi Komunal i Prizrenit	38,150,726.72
5	Ministria e Shëndetësisë	37,806,217.28
6	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor	33,071,846.26
7	Agjencia Qendrore e Prokruimit	31,200,577.75
8	Komuna Ferizaj	30,534,006.91
9	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	28,891,994.60
10	Kuvendi Komunal - Gjilan	22,987,491.38
11	Kuvendi Komunal - Rahovec	22,455,741.60
12	Ministria e Arsimit	20,345,779.79
13	Komuna e Vushtrrisë	19,835,531.36
14	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.	19,168,278.62
15	Komuna e Gjakovës	18,052,363.42
16	Komuna e Podujevës	15,063,816.47
17	Komuna e Kamenicës	11,517,452.27
18	Komuna Shtime	10,788,572.23
19	Telekomi i Kosovës Sh.A	10,598,253.51
20	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	10,595,113.56

Tabela më poshtë paraqet 10 Operatorët Ekonomik me më së shumti kontrata të nënshkruara gjatë periudhës raportuese sipas vlerës së kontratës, si të vetëm apo si grup i operatorëve ekonomik.

Table 10 OE me vlerën më të madhe të kontratave të nënshkruara

OPERATORËT EKONOMIK	VLERË
Bm Group Sh.P.K.	30,355,087.71
Meditech	29,460,573.47
Grup i Operatorëve Ekonomik Lika Trade Sh.P.K., Lika Company Sh.P.K.;	20,167,109.75
Grup i Operatorëve Ekonomik Salillari, Gjini Construction Shpk, Hidroterm Shpk	18,162,896.19
Grup i Operatorëve Ekonomik B-Bardhi Shpk, Besa Company Shpk, Linda	17,988,067.70
R & Rukolli	16,982,097.51
Grup i Operatorëve Ekonomik Lika Company Shpk, Lika Trade Shpk,	13,640,098.91
Santefarm Shpk	12,960,737.84
Grup i Operatorëve Ekonomik Rinesa Shpk, ILEAA-GR Shpk, Limi Project Shpk	11,452,417.96
Grup i Operatorëve Ekonomik H&B Consulting Shpk; Curri Shpk	10,971,578.49

Kurse, tabela më poshtë paraqet 10 Operatorët Ekonomik me më së shumti kontrata të nënshkruara gjatë periudhës raportuese sipas numrit të kontratave të nënshkruara.

Table 11 OE me numrin më të madh të kontratave të nënshkruara

OPERATORËT EKONOMIK	NUMRI
Infinit Sh.P.K.	143
Europrint Group Sh.P.K.	54
Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.	53
Bms Solutions L.L.C.	49
KEIS(Kosova Ex.Imp.Supply Pharmaceut)" Sh.p.k.	46
Flamur Isufi B.I.	40
As Tech Sh.P.K.	38
Agani Ltd Sh.p.k.	35
AWA Sh.P.K.	35
Aritech	34

Aktivitetet e Anuluara të Prokurimit Publik

Në këtë pjesë të raportit është analizuar numri i aktiviteteve të anuluar të prokurimit publik nga ana e Autoriteteve Kontraktuese (AK) në raport me numrin e aktiviteteve të prokurimit të inicuar dhe publikuar për periudhën Janar – Shtator 2025.

Të dhënat në bazë të cilave janë kryer këto analiza, janë marrë nga sistemi e-prokurimi (e-prokurimi.rks-gov.net) dhe të njejtat paraqesin bazën kyçe të rezultateve të mëposhtme. Gjatë periudhës raportuese 2025, bazuar në të dhënat e sistemit, rezultojnë të jenë inicuar dhe publikuar gjithsej **5,484** procedura, duke përfshirë njoftimet për kontratë B05, njoftimet për konkurs projektimi (B06) dhe procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë. Kurse **1,375** aktivitete sipas statusit janë anuluar, pa përfshirë ato me vlera minimale.

Nga të dhënat shihet se në krahasim me procedurat e inicuar, gjatë vitit 2025 aktivitete të anuluar rezultojnë të jenë **25.07%**.




Figure 11 Struktura në përqindje e aktiviteteve të anuluar të prokurimit publik

Numri aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës

Grafiku më poshtë paraqet numrin e aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës dhe tregon shpërndarjen e këtyre anulimeve në katër kategori.

- **Furnizimi** ka numrin më të lartë të anulimeve, me 672 aktivitete të anuluar.
- **Shërbimet** pasojnë me 433 aktivitete të anuluar.
- **Punët** kanë 262 anulime.
- **Konkurset e projektimit** kanë numrin më të vogël, me vetëm 8 aktivitete të anuluar.

Ky grafik tregon se aktivitetet me numrin më të madh të anulimeve janë ato për furnizim dhe shërbime.




Figure 12 Numri i aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës

Sa i përket llojit të kontratës, të dhënat tregojnë se gjatë periudhës raportuese të vitit 2025 numrin më të madh të aktiviteteve të anuluar e kanë pasur kontratat për furnizime dhe shërbime. Sipas përqindjeve të paraqitura në grafikun më poshtë: **(48.87%)** e aktiviteteve të anuluar i takojnë kontratave për furnizim, **(31.50%)** u përkasin kontratave për shërbime, **(19.05%)** lidhen me kontrata për punë, ndërsa vetëm **(0.58%)** i referohen konkurseve të projektimit.




Figure 13 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas llojit të kontratës

Numri aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës

Bazuar në aktivitetet e anuluar sipas vlerës së kontratës, 206 aktivitete të anuluar janë me vlerë të madhe, 754 aktivitete të anuluar janë me vlerë të mesme, 372 aktivitete të anuluar janë me vlerë të ulët dhe 43 janë minitender.




Figure 14 Numri i aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës

Referuar strukturës në përqindje të numrit të aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës, rezulton që më së shumti janë anuluar kontrata me vlerë të mesme (**54.84%**), me vlerë të ulët janë (**27.05%**), me vlerë të madhe (**14.98%**) dhe minitender (**3.13%**).




Figure 15 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas vlerës së kontratës

Numri/përqindja e aktiviteteve të anuluar para apo pas hapjes së ofertave

Në grafikun më poshtë janë të paraqitura aktivitetet e anuluar para hapjes së tenderëve dhe pas hapjes së tyre. Nga të cilat, **1,149** aktivitete të prokurimit janë anuluar pas hapjes së ofertave dhe **226** aktivitete të prokurimit janë anuluar para hapjes së ofertave.



Figure 16 Aktivitetet e anuluar para apo pas hapjes së ofertave

Sipas strukturës në përqindje, **(83.56%)** e aktiviteteve të anuluarat të prokurimit publik janë bërë pas hapjes së ofertave dhe **(16.44%)** e tyre janë anuluar para hapjes së ofertave.



Figure 17 Struktura e aktiviteteve të anuluarat para apo pas hapjes së ofertave

Arsyet dhe referenca bazë për anulimin e aktiviteteve të prokurimit

Gjatë procesit të anulimit të aktivitetit të prokurimit, Autoritetet Kontraktuese janë të detyruara të selektojnë opsionin përkatës në Formularin B10 dhe të specifikojnë arsyen konkrete që ka çuar në anulimin e aktivitetit të prokurimit. Sipas formularit B10, AK duhet të selektojnë arsyet e anulimit të procedurës së prokurimit publik, siç është parashikuar:

Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik:

Pas hapjes së ofertave:

- *Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit;*
- *Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;*
- *Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;*

Para hapjes së ofertave:

- *Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.*

Bazuar në aktivitetet e anuluar për periudhën janar-shtator 2025, arsyetimet nga ana e AK janë si vijon:

Table 12 Arsyet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Nr.	Arsyet e deklaruara nga AK	Numri	Vlera në %
1.	Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit;	226	16.44%
2.	Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit	954	69.38%
3.	Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit;	87	6.33%
4.	Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;	108	7.85%
Totali:		1,375	100%




Figure 18 Struktura e arsyeve të anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Nga totali i aktiviteteve të anuluar, 92 prej tyre janë anuluar për shkak të vendimit të OSHP-së, 398 për shkak që asnjë nga ofertat e pranuar nuk ishte e përgjegjshme dhe 421 për shkak të mungesës së ofertave nga ana e OE për atë aktivitet prokurimi.

Table 13 Arsytet shitesë të anulimit të aktiviteteve të prokurimit

Nr.	Arsyet e deklaruar nga AK tek info shitesë	Numri	Vlera në %
1.	Për shkak të vendimit të OSHP-së	92	6.70%
2.	Nuk është pranuar asnjë ofertë e përgjegjshme	398	28.94%
3.	Nuk është pranuar asnjë ofertë nga OE	421	30.62%
4.	Arsye të tjera	464	33.74%




Figure 19 Struktura e aktiviteteve të anuluar sipas arsyeve shitesë

Konkluzione

Gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2025, prokurimi publik në Kosovë ka vazhduar të karakterizohet nga një nivel i qëndrueshëm aktiviteti, me një vlerë totale të kontratave të nënshkruara prej **752.7 milion** euro. Sipas llojit, nga kontratat e nënshkruara dominojnë ato për punë **(64.68%)** duke treguar fokusin e vazhdueshëm në projektet kapitale dhe infrastrukturore.

Shpërndarja e kontratave sipas vlerës reflekton një përqendrim më të madh në kontratat me vlerë të madhe me rreth **82.4%** për t'u pasuar nga ato me vlerë të mesme **16.25%**. Referuar kriterit të dhënies, **87.6%** e kontratave të nënshkruara janë bazuar në çmimin më të lirë, kurse **12.4%** e tyre sipas kriterit TEMF.

Procedura e hapur ka qenë forma më e përdorur për dhënien e kontratave **(94.21%)**, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe konkurrencës. Përdorimi i kufizuar i procedurave të negociuara **(5.14%)** mbetet brenda kufijve të rekomanduar për praktika më të mira të qeverisjes së fondeve publike.

Kurse, sa i përket Autoriteteve Kontraktuese gjatë periudhës referuese vërehet një shpërndarje e balancuar ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre lokale, ku Ministria e Kulturës, SHSKUK dhe Ministria e Infrastrukturës prijnë për nga vlera dhe numri i kontratave të nënshkruara.

Në përgjithësi, periudha Janar-Shtator 2025 shënon një vazhdimësi pozitive në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit publik, duke reflektuar një qasje transparente dhe dinamike që forcon trendet e mëparshme pozitive drejt një sistemi më efikas, të drejtë dhe të qëndrueshëm në menaxhimin e burimeve publike.

Krahasimi i raportit Janar-Shtator 2025 me raportin Janar – Shtator 2024

Referuar raportit të Statistikave të Prokurimit Publik sipas periudhës referuese janar-shtator 2024 dhe janar – shtator 2025, vërejmë se në përgjithësi kemi një trend rritje të vlerës totale të kontratave të nënshkruara për rreth 25% më shumë gjatë vitit 2025 se sa periudha e njëjtë e vitit paraprak.

Vlera e Kontratave të Nënshkruara:

1. 2025:

- Vlera totale e kontratave të nënshkruara është 752,7euro.
- Nga kjo, 64.68% janë kontrata për punë, 23.93% për furnizim, dhe 11.39% për shërbime.

2. 2024:

- Vlera totale e kontratave të nënshkruara është 600.1 milion euro.
- Nga kjo, 49.56% janë kontrata për punë, 35.79% për furnizim, dhe 14.65% për shërbime.

Në krahasim me vitin 2024, vlera totale e kontratave për vitin 2025 është më e lartë (752.7 milion euro kundrejt 600.1 milion euro), që tregon një rritje të aktivitetit të prokurimit. Po ashtu, ndarja e kontratave për punë dhe furnizim ka pësuar ndryshime. Në 2025, kontratat për punë përbëjnë 64.68% të totalit, duke u rritur në krahasim me vitin 2024 (49.56%). Përkundrazi, pjesa e kontratave për furnizim dhe shërbime duket se ka pësuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak.

Procedura e Prokurimit:

1. 2025:

- 94.21% e kontratave janë nënshkruar me procedurë të hapur (709.1 milion euro).
- 5.14% janë nënshkruar përmes procedurës së negociuar pa publikim (38.7 milion euro).
- 0.51% janë minitender (3.8 milion euro).

2. 2024:

- 90.6% e kontratave janë nënshkruar me procedurë të hapur (544 milion euro).
- 7.4% janë nënshkruar me procedurë të negociuar (44.4 milion euro).
- 1.94% janë punë shtesë (11.7 milion euro).

Sa i përket procedurës së prokurimit, vërehet një rritje të përqindjes së kontratave të nënshkruara me procedurë të hapur në vitin 2025 (94.21%) krahasuar me vitin 2024 (90.6%). Po ashtu, ka një rënie të konsiderueshme të kontratave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, që tregon një kalim më të madh në procedura të hapura gjatë vitit 2025.

Kriteri i Dhënies së Kontratave:

1. 2025:

- 87.60% e kontratave janë nënshkruar sipas kriterit "çmimi më i ulët" (659.4 milion euro).
- 12.40% janë nënshkruar sipas kriterit TEMF (93.3 milion euro).

2. 2024:

- 88.77% e kontratave janë shpërblyer sipas kriterit "çmimi më i ulët" (532.2 milion euro).
- 11.23% sipas kriterit TEMF (67.8 milion euro).

Sa i përket kriterit të dhënies, vërehen ndryshime të lehta në shpërndarjen e kontratave sipas kriterëve, me përqindje të ngjashme (rreth 88% për çmimin më të ulët dhe 12% për TEMF). Vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit TEMF është më e lartë në vitin 2025 (93.3 milion euro kundrejt 67.8 milion euro në 2024), që mund të sugjerojë një tendencë për kontrata më komplekse dhe me vlerë më të lartë në vitin 2025.

AK që kanë nënshkruar më shumë kontrata:

Autoritetet që kanë dominuar në periudhën Janar-Shtator 2025 janë të ngjashme me ato të vitit 2024, megjithatë përqindjet e shpërndarjes së vlerës së kontratave mes niveleve qendror dhe lokal janë më të balancuara në 2025. Niveli qendror duket se ka pasur një aktivitet më të lartë krahasuar me nivelin lokal.

Kontratat e nënshkruara sipas Vlerës:

1. 2025:

- 82.42% e kontratave janë me vlerë të madhe (620.4 milion euro).
- 16.25% janë me vlerë të mesme (122.3 milion euro).
- 0.68% janë me vlerë të vogël (5.1 milion euro).
- 0.14% janë me vlerë minimale (1.1 milion euro).
- 0.51% janë minitender (3.8 milion euro).

2. 2024:

- 76% e kontratave janë me vlerë të madhe.
- 21% janë me vlerë të mesme.
- 3% janë me vlerë të vogël, minimale dhe mini-tenderë.

Referuar kontratave të nënshkruara sipas vlerës, përqindja e kontratave me vlerë të madhe është rritur në vitin 2025 (82.42%) krahasuar me vitin 2024 (76%), kurse pjesa e kontratave të nënshkruara sipas vlerës së mesme dhe të vogël është zvogëluar. Kjo sugjeron një tendencë për kontrata me vlerë më të madhe dhe më komplekse në vitin 2025. Në përgjithësi, periudha Janar-Shtator 2025 tregon një rritje të aktivitetit të prokurimit publik në krahasim me vitin 2024, me një vlerë totale më të lartë të kontratave të nënshkruara, një përqindje më të madhe të kontratave të nënshkruara për punë, një kalim më të madh në procedurat e hapura, një rënie e konsiderueshme e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Megjithatë, ka një tendencë në rritje sa i përket kontratave të nënshkruara sipas kriterëve të TEMF dhe një rritje të kontratave të nënshkruara me vlerë të madhe.

